



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:062503

Datë: 15.11.2023

Numri i dokumentit: 04925712

C.nr.2641/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHËKOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses sh.a “K. . . ” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson E. B. – zyrtare ligjore tek paditësja, ndaj të paditurës Sh. K. nga Fushë Kosova, me objekt kontesti kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 496.94 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 09.11.2023, me datë 15.11.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses sh.a.” K...” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Sh. K. që paditëses t’ia paguajë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 496.94 euro, me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh me kërcënim të përbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, me datë 04.06.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim të dëmit material, duke theksuar se e paditura prej datës së pavërtetuar e deri me datë 05.02.2014 me qëllim që vetës t’i sjellë pasuri të kundërligjshme e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që është furnizuar me energji elektrike direkt jashtë orëmatësit. Ka shtuar se me veprimin e saj e paditura i ka shkaktuar paditësit dëm material në vlerë prej 496.94 euro. Tutje ka theksuar se Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin P.nr.449/16, të datës 05.05.2020 e ka hedhë aktakuzën të ngritur kundër të pandehurës Sh. K. , për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Ndërsa, gjatë shqyrtimit përgatitor, kryesor dhe në fjalë përfundimtare përfaqësuesja e paditëses ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke qëndruar pranë konstatimeve të bëra për dëmin e shkaktuar me rastin e shfrytëzimit të energjisë elektrike pa njëisor, me çka nënkupton se është lidhur direkt në rrjet elektrik dhe energjia e shpenzuar nuk është faturuar, e ky dëm që është bërë nga e paditura është në vlerë prej 496.94 euro, kalkulim i bërë në përputhje me ligjin dhe rregullat në fuqi.

Shpenzimet i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi e as nuk ka prezantuar në seancat gjyqësore të mbajtura, edhe pse ftesën e ka pranuar me rregull.

Gjykata, për të vërtetuar sa më saktë dhe drejtë gjendjen faktike, ka administruar këto prova: Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.449/16, i datës 05.05.2020; Kallëzimi penal NR.CMS-K/DPR-708, i datës 02.04.2014; Procesverbali për praninë të instalimit elektrik, me numër 015288, i përpiluar nga “K...” , i datës 21.02.2014; Procesverbali i përpiluar nga “K...”, me nr. 0798207, i datës 05.02.2014; Dokument me të dhënat e të paditurës si konsumatorë e paditësit; Fatura me nr. 09/2014, e datës 11.03.2014; Fatura DPR-14HP13169, e datës 13.09.2014.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.449/16, i datës 05.05.2020, gjykata vërtetoi faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë me këtë aktvendim, për shkak të parashkrimit absolut, e kishte hedhur poshtë aktakuzën e prokurorisë me të cilën e paditura ishte akuzuar për veprën penale “Lidhje e paautorizuar në shërbim”, nga neni 321 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Nga kallëzimi penal NR.CMS-K/DPR-708, i datës 02.04.2014, gjykata vërtetoi faktin se tani paditësja, kishte ushtruar kallëzim penal ndaj të paditurës me datë 02.04.2014, në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Nga procesverbali i përpiluar nga “K...” , me nr. 0798207, i datës 05.02.2014, gjykata vërtetoi faktin se punëtorët e paditëses – “K...” kishin përpiluar këtë procesverbal ku kishin konstatuar se konsumatori, tani i padituri, është lidhur ilegal në rrjet pa njësor elektrik, dhe ishte shkyçur në shtyllë.

Nga fatura me nr. 09/2014, e datës 11.03.2014 gjykata vërtetoi faktin se energjia që i ishte faturuar të paditurës për periudhën për të cilën kërkohet kompensimi i dëmit ishte 1,100.00 kW.

Gjykata administroi edhe prova tjera, por të njëjtat nuk ishin të mjaftueshme për të vendosur ndryshe.

Gjykata provat e lartcekura të përpiluara nga ana e paditëses – “K...” , nuk i mori për bazë për ta vërtetuar përgjegjësinë e të paditurës, e rrjedhimisht as lartësinë, pasi që të njëjtat nuk janë prova të mjaftueshme për të vërtetuar përgjegjësinë, përkatësisht fajësinë e të paditurës në shkaktimin e dëmit të pretenduar, ndërsa paditësja për vërtetimin e përgjegjësisë së paditëses, e pastaj edhe lartësinë e dëmit nuk i ka ofruar asnjë provë të besueshme gjykatës, siç mund të jetë ekspertiza nga ekspertë të pavarur gjyqësorë, apo aktgjykimi i marrë në procedurë penale, ndërsa me aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ishte hedhur aktakuza e ngritur ndaj tani paditëses.

Në këtë drejtim, gjykata për ta vërtetuar këtë fakt, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.08.2023, sipas detyrës zyrtare, e duke u mbështetur në nenin 356 të LPK-së, lidhur me nenin 21 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore, sipas detyrës zyrtare kishte marrë aktvendim që në këtë çështje juridike kontestimore të nxirret prova me anë të ekspertizës nga fusha e elektros, për ta vërtetuar përgjegjësinë lidhur me dëmin e pretenduar nga ana e paditëses, e më pastaj edhe lartësinë, duke e detyruar kështu paditësen që të paguajë shumën prej 100 eurove në emër të kësaj ekspertize, por e paditura nuk e kishte paguar këtë shumë, dhe rrjedhimisht gjykata nuk e ka marrë këtë provë me anë të ekspertizës.

Me nenin 319 të LPK-së është paraparë që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Me këtë dispozitë rregullohet çështja e të provuarit të fakteve mbi të cilat secila palë e bazon kërkesën dhe pretendimet e saja, e në këtë rast paditësja nuk ka arritur që ta provojë faktin kryesor në këtë çështje juridike kontestimore, atë të ekzistimit të përgjegjësisë së të paditurës për dëmin e pretenduar.

Andaj, në mungesë të provave të cilat mbështesin pretendimet e paditëses se e paditura i ka shkaktuar dëmin e pretenduar dhe në lartësinë e pretenduar nga paditësja, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së, pasi që pala që ka pasur sukses në këtë procedurë, përkatësisht i padituri, nuk ka pasur shpenzime të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2641/20, datë 15.11.2023

Gjyqtari

Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.